



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE MRBOJTJE DHE SHPËTIM

Data:	04.06.2025
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Burim Rrustemi – Drejtor i DSHPMSH-së
Lënda:	Raporti i muajit Maj 2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të DSHPMSH-së gjatë muajit Maj 2025, DSHPMSH-ja ka kryer aktivitetet që ka pasur të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- Pranimi, evidentimi, zgjedhja dhe arkivimi i lëndëve të arritura nga qytetarët apo institucionet të tjera.
- Është bërë barazimi i të hyrave nga hapësirat publike dhe nga mirëmbajtja e tregjeve.
- Janë bërë kërkesa DBF-së për zotim të mjeteve nga kategoria mallra shërbime dhe komunal
- Është përgatit dhe është shpallë “Shpallja publike “ për ndarjen e rrezeve të udhëtimit operatorëve të transportit të udhëtarëve me autobus në teritorin e komunës së Lipjanit
- Kërkesë Kryetarit të Komunës për formimin e aplikacioneve për ndarjen e rrezeve të udhëtimit operatorëve të transportit të udhëtarëve me autobus.
- Kërkesë KRM Pastrimit për intervenimin dhe rregullimin e disa aseteve të dëmtuara në tregje.
- Kërkesë Drejtorisë së Prokurimit për iniciimin e procedurave: Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave publike në qytetin e Lipjanit, Zhavorimi i rrugëve në qytetin e Lipjanit, mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror sipas Lotove. Mbledhja, grumbullimi dhe bartja e mbeturesave në 2 Loto, zona lindore dhe zona perendimore
- Është dhënë pëlqim për shfrytëzimin e hapësirës publike në shesh për realizimin e aktivitetit me karakter shëndetësor për ditën Ndërkombëtare të Infermerisë, për realizimin e një murali kundër bullizmit nëpër shkolla, shfrytëzimi i njëres korsi të rrugës Avdi Kelmendi dhe prerje tërthore të rrugës “Tahir Sinani”
- Janë dhënë Vendime për shfrytëzim të hapësirës publike para lokaleve afariste.
- Është duke u hartuar Rregullorja për Rrugët Publike Lokale
- Janë përgatit paramasa nga menaxherët.
- Janë duke u shqyrtuar aplikacionet për ndarjen e licencave për operatorët auto taksi
- Pjesëmarrja në vlerësim të ofertave tenderuese në Drejtoratin për Prokurim.
- Janë bërë intervenime në rrjetin e ndriçimit publik, ndërrim i siguresave në vendbanimet dhe gjatë rrugëve ku shtrihet ndriçimi publik në qytetin e Lipjanit.

- Janë bërë intervenime në sanimin e rrjetit të kanalizimit për (debllokim) në vendbanime dhe në qytet ku është paraqitur nevoja, vendosje të kapakëve të pusetave të rrjetit të kanalizimit etj.

Mbikqyrja e kontratave kornizë:

- Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera publike në qytetin e Lipjanit.
- Menaxhimi i tregjeve të Lipjanit
- Mirëmbajtja e ndriqimit publik në qytet dhe në fshatra.
- Hapja - pastrimi i lumenjëve dhe hapësirave tjera publike në fshatra.
- Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në Komunën e Lipjanit
- Pastrimi i varrezave dhe sanimi i lapidarëve
- Mirëmbajtja e Infrastrukturës së rrugëve dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit
- Mirëmbajtja e rrjeteve të kanalizimit në qytet dhe fshatra.
- Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror në qytet dhe fshatra në Komunën e Lipjanit.

Puna me palë dhe punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve

STATISTIKAT

Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHPMSH-së

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
52	36		4	12

Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHPMSH-së

Pasqyra e aktiviteteve të DSHPMSH-së		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr.
1	Kërkesa, njoftime, pëlqime, përgjigje si dhe shkresa të ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	25
2	Përgatitja e paramasave dhe paralogarive	3
3	Takime zyrtare në Ministri, KEDS AME dhe institucione tjera	1
4	Vizita në teren	65
5	Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme	1
6	Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve	2

